



INSTITUCIONET E PËRKOSSHME VETQEVERISËSE
PRIVREMENA INSTITUCIJA SAMOUPRAVE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVES / MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
VLADA KOSOVA / MINISTARSTVO JAVNIH SLUŽBI
GOVERNMENT OF KOSOVA / MINISTRY OF PUBLIC SERVICES

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS I KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR KOSOVA

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN

2005

Prishtinë, janar 2006

P ë r m b a j t j a

Shkurtesat	2
Hyrje,qëllimi	3
Themelimi dhe përbërja e këshillit	4
Funkcionet e këshillit	5
Funkcioni i ankesave	6 - 7
Tabela dhe grafikone	8 -14
Vlersimi i rrespektimit të ligjit	15
Forma e pyetësorit.....	16 - 18
Veçoritë e vlersimit me tabela.	19 - 29
Funkcioni i vëzhgimit të drejt. të dep.me tabela e grafikone	30-36
Komente të përgjithëshme.....	37
Sfidat dhe vështirësitë	38
Sygjerimet.....	39
Përmbledhje	40

SHKURTESAT

IPVQ -Institucionet e Përkohëshme të Vetëqeverisjes

PSSP - Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

KPM - Këshilli i Pavarur Mbikqyrës

MSHP - Ministria e Shërbimeve Publike

SHKC - Shërbimi Civil i Kosovës

RREG- rregullore mbi SHCK92001/36)

UA - Urdhëresa Administrative (2003/2)

AP - Autoriteti Punëdhënës

QKUK-Qendra Klinike Univesristare e Kosovës

MEF-Ministria e Ekonomisë dhe Financave

MEM-Ministria e Mejdisit dhe Minierave

MKRS-Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve

MP - Menagjer Personeli

KE - kryeshef ekzekutiv i Komunës apo Agjencionit Ekzekutiv

SMPS- Indstituti i menagjimit të shërbimeve publike-Londër

OSCE - Organizata për Bashkpunim e Siguri ne Europë

H Y R J E

Këshilli i Pavarur Mbikqyrës i Kosovës(KPMK} duke u bazuar në nenin 14.1 të rregullores së UNMIK-ut mbi Shërbimin Civil të Kosovës(nr 2001/36},nenin 25 të Rregullores mbi Rregullat e Punës të KPMK(UA MSHP 2005/01),pas shqyrtimit të gjithëanshëm dhe sistemimit të dokumentacionit egzistues,Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithëshëm të Kombeve të Bahkuara për Kosovën(PSSP),Kryeministrit të Kosovës ,Ministrës së Ministrisë së Sërbimeve Publike(MSHP) i paraqet raportin vjetor të punës.

Raporti vjetor përfshinë periudhën raportuese 01.01.2005 deri me 31.12.2005,dhe ka për qëllim të paraqet punën e bërë nga këshilli,aktivitetet e ndërmarra,të pasqyroj të arriturat e sukseset e këshillit,të theksojë problemet dhe ngecjet në SHCK dhe japë komentet e sygjerimet për të ardhmën.

Historia dhe qëllimi

Në kohën e ndryshimeve të mëdha në Kosovën e pasluftës u krijuan edhe realitete të reja në të gjitha sferat jetësore e sidomos në lëminë juridiko-politike ku ndyshuan burimet formale të së drejtës e në këtë kontekst me rregulloren 2001/36 u krijua Këshilli i Pavarur Mbikqyrës i Kosovës si organ i ri ,specifik **sui generis** dhe pak i njohur në teorinë dhe praktikën juridike në Kosovë.

Këshilli është themeluar me qëllim të mbikqyrjes së zbatimit të Rregullorës mbi Shërbimin Civil të Kosovës(SHCK),rrespektimit të parimeve udhëheqëse të tij mbi të cilat është ngritur dhe si nje mekanizëm efikas i cili garanton nje shërbim civil multietnik,profesional,të baraspeshuar në mes të gjinive,të pa anshëm ,etik dhe të përgjegjshëm.

Themelimi dhe përbërja e këshillit

Këshilli i Pavarur Mbikqyrës i Kosovës është themeluar në bazë të rregullores 200/136 mbi SHCK-kapitulli III.

Këshilli përbëhet nga 7 anëtarë që i emëron PSSP në konsultim me kryeministrin.

Përbërja e këshillit pasqyron karakterin shumetnik të Kosovës dhe përbëhet nga katër anëtarë shqipëtar, dy anëtar pjestarë të komuniteteve minoritare dhe në fazën e tij fillestare edhe me një anëtar ndërkombëtarë ,specialist në fushën e administrimit civil i cili pas një viti zëvendësohet me një anëtar vendor të këshillit.

Në përputhje me normat ligjore këshilli është njësi autonome brenda Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe finansohet nga buxheti i kësaj Ministrie.

KPMK është formuar më 23 shtator 2004 dhe brenda dy vitesh nga dita e formimit do të transformohet në një organ që direkt i raporton Kuvendit të Kosovës.

Anëtarët e këshillit në kuptimin e ligjit mbi SHCK nuk janë shërbyes civil.

Këshilli ka kryetarin e këshillit i cili zgjedhet nga këshilli.

Më qëllim të kryerjes së punëve ndihmëse teknike ministria e SHP i ka sigurua këshillit një staf administrativ i cili i ndihmon KPMK-së në kryerjen e funksioneve të tij, të cilët janë të organizuar në sekretariatit e këshillit dhe të cilët janë shërbyes civil.

Këshilli i raporton drejtpërsëdrejti Ministres së Shërbimeve Publike PSSP dhe Kryeministrit.

Funkcionet e këshillit

Këshilli i Pavarur Mbikqyrës i Kosovës është organ:

- Që në shkallë të fundit i shqyrton ankesat e shërbyesve civil deri në nivel të drejtorvë të departamenteve në procedurë administrative konform LSHCK. (funkcioni i ankesave)

- Më i lartë i administratës i cili ushtron kontrollin e zbatimit të Ligjit të Shërbimit Civil në IPVQ (Ministri, komuna duke përfshirë sekretariatit e Kuvendit të Kosovës, Kryeministrinë, arësimin dhe shëndetësinë

- Organ që vëzhgon dhe vendos për ligjshmërinë e zgjedhjes së Drejtorëve të Departamenteve (Ministri, Komuna, duke përfshirë sekretariatit e Kuvendit të Kosovës dhe Kryeministrinë,

- Organ që jep vlerësimin e rrespektimit të parimeve të Ligjit mbi Shërbimin Civil në IPVQ-të si dhe punë tjera sipas kërkesës së PSSP-së dhe Kryeministrit dhe raportin vjetor ia dërgon Kryeministrit dhe PSSP-së

Bazën ligjore për ushtrimin e funksioneve të lartpërmendura KPMK e ka të paraparë me:

- Rregulloren mbi SHCK (2001/36)
- UA, 2003/2 Mbi implementimin e Rreg 2001/36
- Rregulloren mbi Punën e KPMK (UA 2005/01 MSHP)
- Rregulloren mbi Proceduar e Ankesave të KPMK-së (UA 2005/02 MSHP)

- KPMK zbaton edhe ligjet e aplikueshme në Kosovë sipas rreg nr.1999/24 mbi ligjin e zbatueshëm në Kosovë.

- Këshilli ka hartua edhe pyetësor (formë)me kritere që u përmbahet me rastin e kryerjes së funksionit të vlersimit të rrespektimit të LSHCK.

Funkcioini i ankesave

Njëri nga funksionet më të rëndësishme të këshillit është pikërisht funksioni i zgjedhjes së ankesave të shërbyesve civil deri në nivelin e Drejtoreve të Departamenteve dhe aplikuesëve ne SHCK.Duke kryer këtë funksion sipas dispozitave ligjore KPMK dëshmon profesionalitetin e tij dhe përkushtimin e anëtarëve të tij për pa anësi dhe qasje tërsisht korrekte ndaj të gjithëve pa marrë parasysh etnitetin,gjininë,moshën,orientimin politik a tjera.

Është e domosdoshme të theksohet se këshilli deri me datën 08 gusht 2005 nuk ka pasur Rregullore Mbi Procedurat e Ankesave kur është përpiluar si draft nga vet KPMK dhe është dërguar në MSHP pas përpunimit të tij me modifikimet e domosdoshme është nënshkruar nga Ministrja e MSHP dhe më pas ka marrë miratimin e Kryeministrit dhe PSSP-së.

Duke e marrë parasysh këtë fakt këshilli të gjitha ankesat që kan arritur pas datës kur është miratuar rregullorja ka vendosur ti shqyrtojë me prioritet pasi që edhe është i lidhur me afate konkrete për zgjidhjen e tyre ndërsa ato para kësaj date do ti zgjedhë sipas mundësivë që ka.

Për secilën lëndë të ankesës që ka për ta zgjidhur këshilli formon një komision tre anëtarësh i cili procedon me ankesën prej fillimit e deri te marrja e vendimit përfundimtar.

Këshillit gjat periodës janar-dhjetor 2005 i kan arritur për shqyrtim 169 ankesa të cilat janë rexhistruar në sekretariat dhe jan protokoluar sipas procedurës së paraparë.

Prej këtyre ankesave në 132 raste ato janë ushtruar nga nëpunësit e Shërbimit Civil të Kosovës, të cilët në ankesa pretendojnë se me vendimet e Autoritetit Punëdhënës u është cenuar ndonjë e drejtë nga marrëdhënja e punës.

37 Ankesa kanë arritur nga aplikuesit për punësim në Shërbimin Civil të Kosovës. Duke elaboruar rastet e ankesave KPMK ka konstatuar se ato janë të natyrave të ndryshme:

- për shkelje të rregullave të konkursit 37 raste,
- për ndërprerje të kontratës së punës 76 raste
- për mos vazhdim të kontratës së punës 23 raste
- për degradim (ulje pozite) 7 raste,
- për kompensim të të ardhurave personale 17 raste
- për shqiptimin e masave disiplinore 3 raste,
- për suspendim nga puna 3 raste
- të natyrave tjera 3 raste

nga rastet e sipërpërmendura mund të konstatohet se 43 ose 25 % të ankesave kanë qenë të parashtruara nga femrat dhe 126 raste ose 75 % kanë qenë ankues meshkujt.

Sipas përkatësisë nacionale të ankuesëve këshillit i kanë arritur 163 ankesa nga ankuesit shqiptar ose 96 % dhe 6 ankesa ose 4 % nga minoritetet.

Nga pjestarët e komunitetit serb janë ushtruar 4 ankesa, dy nga meshkujt dhe dy nga femrat dhe të gjitha me natyrë të lëndës **„ndërprerje e marrëdhënjes së punës**. Ndërsa dy ankesa tjera kanë arritur, një nga komuniteti boshnjak dhe një nga komuniteti turk me të njëjtën arsye të ankesës për ndërprerjen e marrëdhënjes së punës. Vlenë të përmendet fakti se gjatë vitit 2003 kanë arritur 8 e gjatë vitit 2004 90 ankesa


Në përputhje me shënimet e lartcekura shih tabelën në vijim nr 1. dhe me pas edhe grafikonet përkatëse.


Pasqyra e ankesave shprehur ne % sipas natyres ,gjinise dhe nacionalitetit per periudhen nga dt 01.01.2005 e deri me dt 31.12.2005


Sipas Natyres	Nr. Anke.	Femra	Meshkuj	Shqipëtar	Serbë	Autorite tePunedhenese.	Turq	Boshnjak	të Tjerë	Shprehur Në %
Shkelje konkursi	37	9	28	35	-	1		1		22. %
Nderprerje kontrate	70	19	51	65	4	-	1			41. %
Shkarkim nga posti	6	-	6	6	-		-	-	-	4. %
Degradim	7	3	4	7	-	-	-	-	-	4. %
Suspendim	3	-	3	3						2. %
Kompenzim te Ap.	17	4	13	17	-		-	-	-	10. %
Vlersim jo objektiv	0	0-	0	0	-		-	-	-	00 %
Ndalim Gradimi	0	0	0	0	-		-	-	-	0. %
Mosvazhdim te Kont.	22	7	15	22	-		-	-	-	13. %
<u>Masa Dixiplinor</u>	3		3	3	-		-		-	2. %
<u>Masa tjera</u>	4	1	3	4						2. %
<u>Gjithsejt:</u>	169	43	126	162	4	1	1	1		100. %
<u>Shpr.në %</u>		25. %	75 %	95.85 %	2.36 %	0.59. %	0.59. %	.059. %	.%.	


Perfundon me nr. rendor 169.

Sipas këtyre të dhënave, rezulton se ankesat janë ushtruar më bazë nderprerja e kontratës se punës në 70 raste ose 41.6%, për shkelje konkursi 37 raste ose 22%. Pastaj pasojnë ato për mos vazhdim të kontratës se punës, për kompenzim në të ardhura personale e kështu më radhë. Për të gjitha rastet e ankesave, nga nëpunësi për ankesa, janë formuar lëndë të posaçme.









Komisionet përkatëse të KPMK-së të caktuara nga këshilli për të vendosur lidhur me ankesat deri me tash kanë zgjedhur 79 ankesa dhe ate gjatë vitit 2005, 26 dhe ne dymujorin e këtij viti 53 ankesa. Gjithnje duke përkujtuar mungesën e rregullores së ankesave këshulli ka filuar të zgjedhe ato prej dt. 08.gusht 2005. Lidhur me këtë shif tabelat nr 2 dhe 3.

Tab.Nr.2. Pasqyra e ankesave të vendosura nga dt. 08.08.2005 deri me dt. 31.12.2005.

	Nr. I Ank	Femra	Meshkuj	Shqiptar	Serb	Turq	Bosnjak	Të tjerë	Aprovuar	Ap.pjes ërishtë	refuzuara	hudhura p.	tjera
Nr. I tepsish. I ank. Të shq.	26	07	19	26	-	-	-	-	05	01	17	-	03
Shprehur në %		27%	70%	100%					19.2%	3.8%	65%		11%

Në bazë të të dhënave të mësipërm shihet se 15%, të ankesave të arritura për vitin 2005, janë zgjedhur.

Tab. Nr.3. Pasqyra e ankesave të vendosura nga dt. 08.08.2005 deri me dt.20.02.2006.

	Nr. I Ank	Femra	Meshkuj	Shqiptar	Serb	Turq	Bosnjak	Të tjerë	Të Aprovuara	Të Ap.pjes ërishtë	Të refuzuara	Të hudhura p.	Të tjera
Nr. I tepsish. I ank. Të shq.	53	14	39	53	-	-	-		07	08	34	01	02
Shprehur në %		26.4%	73.6%	100%					13.2%	15%	64%	1.8%	3.6%

Veçoritë e theksuara tek ankesat e arritura

- raste kur ankesat zgjedhen brenda AP nga Kryeshefi ekzekutiv e jo nga komisioni i ankesave
- raste kur AP nuk përgjigjet fare ne ankesën e parashtruar atij,
- raste kur ankesat branda AP i drejtohen insticioneve të ndryshme si inspekcioneve apo sekretarëve permanent(sidomos në sferen e arsimit)
- mos rrespektimi i afateve etj.

Funksioni i vlerësimit të rrespektimit të LSHCK

Duke marrë parasysh faktin se ky është raporti i parë vjetor i punës që paraqet këshilli është e nevojshme të theksohet fakti se me qëllim të ushtrimit të këtij funksioni KPMK ka organizuar vizita njohëse (promovuese) nëpër autoritetet punëdhënëse të SHCK dhe ate me qëllim të njoftimit reciprok me funksionet e këshillit dhe kompetencat e tij si dhe me gjendjen egzistuese ne vetë autoritetin punëdhënë .Gjithashtu qëllim i këtyre vizitave te realizuaa në mes të periudhës 13.12,2004 e deri më 01.03.2005 ishte edhe vendosja e bashkpunimit në mes të KPMK dhe AP ashtu sikur parashifet me nenin 13.4 të LSHCK.

Në këto vizita anëtarët e këshillit kan komunikuar me Sekretarët Permanent të Ministrive,Kryeshefat ekzekutiv të Agjencioneve Ekzekutive dhe KE të Komunave të Kosovës dhe pas kësaj në këshill janë nxjerrë dy konkluzione të përgjithëshme:

- **të gjitha autoritetet punëdhënëse e kan mirpritur formimin dhe fillimin e punës të Këshillit të Pavarur Mbikqyrës,dhe**
- **të gjitha autoritetet punëdhënëse jan deklaruar se do të bashkpusojnë me KPMK-ën ,dhe bashkëpunim e kooperimim i mirë është realizuar me shumicën e A.P.**

Për ta kordinuar në mënyre sa më efikase vizitimin e AP tek të cilat do të vlerësohej zbatimi i Ligjit të Shërbimit Civil të Kosovës ,Këshilli ka hartuar planin e vizitave,ndërsa me qëllim të unifikimit të procedurës së punës dhe kriterëve për komisionet e këshillit që do ta bëjnë këtë vlerësim ,këshilli ka aprovuar **pytësorin unik** i cili ka shërbyer si bazë udhëheqëse për të realizuar Kontrollimet e parapara.(shif.pytësorin unik)

FORMULAR I VLERESIMIT TE RESPEKTIMIT

PERMBAJTJA E TE DIIENAVE PER ZBATIMIN E URDHERESAVE
 ADMINSITRATIVE 2003/2 MB! ZBATIMIN E RR} SE UNMIK-ut
 2001/36 MBI SHEBRIMIN CIVIL TE KOSOVES

Nr.r.	DOKUMENTACIONI	P0	JO
1	<p>PERSONELI</p> <p>1.1 A është emëruar Menxheri i personelit?</p> <p>1.2 A janë bartur autorizimet tek Menaxheri i personelit?</p> <p>1.3 Sa persona i keni në personel?</p> <p>1.4 Vendi ku e mbani dokumentacionin?</p> <p>1.5 A është u një zyre të veçante?</p> <p>1.6 apo ne ndonjë vend të haur?</p> <p>1.7 A ka qasje shërbyesi civil për ti pare ato?</p>		
2	<p>DOKUMENTACIONI</p> <p>2.1 Dokumentacioni mbi kualifikimin dhe përvojën e punës.</p> <p>2.2.,A i keni diplomat origjinale apo kopje?</p>		
3	<p>Regrutimi</p> <p>3.1 Kërkesa për shpalljen e konkursit - Fillimi I regrutimit.</p> <p>3.2 Kush e nënshkruan dhe kush e lejon kërkesën?</p> <p>3.3 Si e publikoni konkursin?</p> <p>3.4 A është n dy gjuhe?</p> <p>3.5 N mediat ku jetojnë komunitet?</p> <p>3.6 Nëse i keni , duhet dorëzuar për te shikuar kontratën ose provat me shkrim, të kontaktimit tuaj me mediat e komuniteteve.</p> <p>3.7 Aplikacionet a janë në dy gjuhe?</p> <p>3.8 Kush vendosë për formimin e komisionit?</p> <p>3.9 A egziston harmonia gjinore dhe inultietnike?</p> <p>3.10 Kontrollimi i nj formulari t intervistimit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Formulari per listen e gjere të kandidatëve - Formulari për listën e ngushte të kandidatëve - Si I ftoni kandidatët? <p>(me formular,telefon).</p> <p>Posaqërishtë të komuniteteve.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Formulari i selektimit final me pyetje? - Formulari për vlerësimin individual final? - Intervista finale — vlerësimi I përgjithshëm. - Rangimi final. - Raporti final i Komisionit zgjedhor. - Kushe nënshkruan këtë raport? <p>4.PUNA PROVUESE</p> <p>4.1 A keni punë sprovuese për shërbyesit civilë?</p> <p>4.2 Sa zgjatë kjo kohë?</p> <p>4.3 Kush e bene mbikqyerjen e punës provuese?</p> <p>4.4 A informohet zyrtari për kohëzgjatjen dhe kushtet e punës provuese?</p>		
	<p>4.5 Kush e udhëzon dhe përkrahë zyrtarin gjate punës provuese?</p> <p>4.6 Menaxheri i personelit a e përkujton udhëheqësin, me kërkesën mbi vlerësimin e punës provuese, që është uë përputhje me planin e punës provuese?</p>		

	<p>4.7 Kush e vlerëson punën provuese? 4.8 A bëhet intervestimi udhëheqës - i punësuar? 4.9 I punësuar a e nënshkruan formularin e punës provuese? 4.10 I punësuar në rast të shkëputjes së marrëdhënies së punës a lajmërohet mbi të drejtën e ankesës? 4.11. A keni pasur raste të shkëputjes së marrëdhënies së punës , për shkak të mosuksesit të punës provuese dhe i punësuar të paraqes ankese? 4.12 Shikimi I nje formulari të punës provuese.</p>		
5	NDËRPRERJS E MARREDHENIES SË PUNËS		
	5.1 Kur e informoni zyrtarin mbi ndërprerjen e marrëdhënies Se punës, pas skadimit të kontratës , p shkak të mosekzistimit të vendimit buxhetor.		
6	<p>PERSHKRIMI I PUNËS</p> <p>6.1 Kush e paraqet kërkesën për vendin e ri të punës? 6.2 Kush e vlerëson se a është i arsyeshëm vendi i ri i punës? 6.3 Kush e përgatit përshkrimin e punëve? 6.4 Kush e lejon hapjen e vendeve të reja të punës? 6.5 A ekziston kopja e përshkrimit të punëve në dosjen personale të punësuarit? 6.6 Shikimi i nje rasti të përshkrimit të punës.</p>		
7	<p>ORARI I PUNËS</p> <p>7.1 A ekziston mbikqejra e qëndrimit në punë? 7.2 Shikimi në evidencën e qëndrimit në punë?</p>		
8	<p>MUNGESAT - PUSHIMI MJEKËSOR</p> <p>8.1 Si e arsyetoni mungesën e punëtorit për 2-3 ditë? 8.2 Si veproni me zyrtarët që kanë shfrytëzuar pushim mjekësor, me pagesë dhe ende nuk janë të aftë për punë dmth. janë të sëmur. 8.3 Si veproni me zyrtarët të diet kanë pasur lëndime Re punë? 8.4 Çfarë dokumentacioni shfrytëzoni për arsyetimin e tyre? - Shënjat mjekësore? - Ose vetëm raportin mjekësor? 8.6 Shikimi i evidencës të mungesës nga puna dhe pushimit mjekësor.</p>		
9	<p>9.GRADIMI</p> <p>9.1 A keni raste të gradimit të punësuarve? 9.2 N i punësuar është graduar; a) A shtë bërë procedura e gradimit nëpërmjet publikimit të konkursit dmth. Procesit të konkurrencës? b) ose është bërë në bazë të rekomandimit së udhëheq dhe vlerësimit pozitiv të punës? 9.3 Nëse është nën b) shikimi në vendimin e shkruar me arsyetim dhe të lejuar nga SP.</p>		

10	<p>MUNDËSITË E NJËJTA</p> <p>10.1 A është emëruar zyrtari i lartë për mundësitë e njëjta?</p> <p>10.2 Nëse është emëruar, a është duke u marrë me çështjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - e rritjes së përfaqësimit të komuniteteve në organizatën e punës, - barazisë gjinore (sa janë të përfaqësuara femrat në punë?) - sa është prania e punëtoreve me aftësi të kufizuara? <p>10.3 A bëhet fjalë për strategjinë e implementimit të mundësive të njëjta:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përkrahja e lajmërimit në punë të personave nga komunitetet, femrave, njerëzve me aftësi të kufizuara; - përkrahja e shfrytëzimit të dygjuhësisë. <p>10.4 A mbikëqyret zbatimin e mundësive të njëjta?</p> <p>10.5 A bëhet fjalë për raportin mbi aplikimin e strategjisë së mundësive të njëjta dhe përparimit të tij gjatë vitit 2005.</p> <p>11.2 Shikimi — Lista e plotësimit të vendeve të lira për Drejtorët e departamenteve në vitin 2005.</p>		
----	---	--	--

Pas kësaj janë kryer vizitat monitoruese për rrespektimin të ligjit të SHCK dhe ato sipas radhës së paraqitur:

- një në administratën e Kuvendit të Kosovës
- një në administratën e Presidencës së Kosovës,
- një në administratën e kryeministrit,
- 13 vizita në Ministrinë e Qeverisë së Kosovës,
- 30 vizita nëpër Komuna,
- 4 vizita në Agjencionet Ekzekutive,
- një në Administratën Tatimore të Kosovës,
- një në administratën e Universitetit
- 14 vizita në fakultetet e UP,
- 8 vizita në QKUK dhe klinikat e saj
- 8 spitale regjionale

Me rastin e këtyre vizitave, Autoritetet Punëdhënëse iu janë dhënë rekomandimet përkatëse në formë të shkruar dhe u është sugjeruar se në cilat sfera lypsen korrigjime e përmirësime, dhe të njëjtat i janë dërguar Sekretarëve Permanent të Ministrive apo KE të komunave, Ministrin përgjegjës dhe Ministres së MSHP. Këshilli ka shqyrtuar zbatimin e rekomandimeve të cilat në masën më të madhe janë përmbushur e aty ku nuk janë zbatuar pa arsye, këshilli vendos në përputhje me nenin 13.3 të rregullimit SHCK lidhur me vizitat e kryera shif tabelat vijuese:

Vizitat - I -

	<i>Reko.e Derguara</i>	Data e Vizitës	Data e Dergimit të Rekomand.	Afati i Përbushjës	Afati I kontrollimit
1	K.K. Ferizaj	11.04.05	20.04.05	Ska afat te Permmushjes	20.06.05
2	K.K. Leposaviq	13.04.05	19.05.05	Ska afat te Permmushjes	19.07.05
3	K.K. Prishtinë	13.04.05 19.04.05	02.06.05	2 Muaj	02.08.05
4	K.K. Malishevë	14.04.05	14.06.05	2 Muaj	14.08.05
5	M. Kulturës Rinisë dhe Sportit	11.04.05	13.06.05	2 muaj	13.08.05
6	Kryeministri	22.04.05	02.06.05	2 muaj	02.08.05
7	K.K. Shtime	25.04.05	13.06.05	2 muaj	13.08.05
8	K.K. Drenasë (Gllgovc)	29.04.05	07.06.05	2 muaj	07.08.05
9	M. Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor	13.05.05	15.06.05	2 muaj + Vazh.	15.08.05
10	K.K. Skenderaj	19.05.05	13.06.05	2 muaj	13.08.05
11	Enti I Statistikës së Kosovës	23.05.05	15.06.05	2 muaj	15.08.05
12	M. Transportit dhe Post Telekomunikacionit	06.05.05	17.06.05	2 muaj	17.08.05
13	M. Bujqësisë Pyltaris & Zh.R.	05.05.05	20.06.05	2 muaj	20.08.05
14	M.SH.P	27.04.05	20.06.05	2 muaj	20.08.05
15	Kuvendi I Kosovës	15.04.05	20.06.05	2 muaj	20.08.05
16	K.K. Vushtrri	12.05.05	23.06.05	2 muaj	23.08.05
17	K.K. Mitrovicë	20.05.05	23.06.05	2 muaj	23.08.05
18	K.K. Besianë (Podujevë)	28.04.05	23.06.05	2 muaj	23.08.05
19	K.K. Gjakovë	27.04.05	24.06.05	2 muaj	24.08.05
20	K.K. Rahovecë	16.05.05	24.06.05	2 muaj	24.08.05
21	K.K. Novo-Berd	25.05.05	29.06.05	2 muaj	29.08.05
22	K.K. Zveqan	09.06.05	01.07.05	2 muaj	01.09.05
23	K.K. Dragash	10.06.05	01.07.05	2 muaj + Vazh.	01.09.05
24	K.K. Lypian	03.06.05	05.07.05	2 muaj +Vazh.	05.09.05
25	K.K. Viti	03.06.05	05.07.05	2 muaj	05.09.05
26	Universiteti I Prishtinesë me Fakultetet	14.06.05	05.07.05	2 muaj + Vazh.	05.09.05
27	M. për Administratën e Qeverisjes Lokale	10.06.05	06.07.05	2 muaj + Vazh.	06.09.05
28	K.K. Dardanë (Kamenicë)	04.05.05	07.07.05	2 muaj + Vazh.	07.09.05
29	Qendra e Studenteve	22.06.05	07.07.05	2 muaj + Vazh.	07.09.05
30	M. Punësë & Mirqenjës Sociale	21.04.05	12.07.05	2 muaj +Vazh.	12.09.05
31	K.K. Fushë Kosovë	18.04.05	12.07.05	2 muaj + Vazh.	12.09.05
32	K.K. Therandë (Suharekë)	06.06.05	14.07.05	2 muaj + Vazh.	14.09.05
33	Agj. Katastral i Kosovës	15.06.05	14.07.05	2 muaj	14.09.05
34	K.K. Shtërpcë	04.07.05	14.07.05	2 muaj	14.09.05
35	K.K. Deqan	13.06.05	13.07.05	2 muaj	13.09.05
36	K.K. Gjilan	15.04.05	14.07.05	2 muaj + Vazh.	14.09.05
37	M. Tregtis dhe Industris	11.05.05	14.07.05	2 muaj + Vazh.	14.09.05
38	M. Arsimit	13.06.05	18.07.05	2 muaj + Vazh.	18.09.05

39	K.K. Istog	08.06.05	20.07.05	2 muaj + Vazh.	20.09.05
40	M. Kthimit	01.07.05	21.07.05	2 muaj	21.09.05
41	M. Ekonomis dhe Financave	17.05.05	22.07.05	2 muaj + Vazh.	22.09.05
42	K.K. Klinë 30.06.05	30.06.05	22.07.05	2 muaj + Vazh.	22.09.05
43	K.K. Kaçanik	09.05.05	22.07.05	2 muaj + Vazh.	22.09.05
44	Agj. Kosoves per Produkte Medicinale	13.06.05	22.07.05	2 muaj + Vazh.	22.09.05
45	IKAP	19.07.05	25.07.05	2 muaj + Vazh.	25.09.05
46	K.K. Obiliq	15.07.05	25.07.05	2 muaj + Vazh.	25.09.05
47	K.K. Prizren	11.07.05	25.07.05	2 muaj + Vazh.	25.09.05
48	Administrata Tatimore e Kosovës	27.06.05	27.07.05	2 muaj + Vazh.	27.09.05
49	K.K. Pejë 06.07.05	06.07.05	27.07.05	2 muaj + Vazh.	27.09.05
50	Minstria e Shëndetësisë	07.07.05	02.08.05	2 muaj + Vazh.	02.10.05
51	Zyra e Kryetarit te Kosvës	11.11.05	05.12.05	2 muaj + Vazh.	05.02.06
52	Agj.i Inspektoratit	01.12.05			
53	Agj.Veterinar	01.12.05			
54	Agj.Pylltaris	01.12.05			

Vizitat e Realizuara në UP-së Qendrën e Studentave & 13 Fakultete					
<i>Nr.</i>	<i>Data</i>	<i>Fakultetet</i>	<i>Ora</i>	<i>E Planifikuar</i>	<i>E Realizuar</i>
1	14.06.2005	Universiteti i Prishtinës	10.0 0	<i>Planifikuar</i>	<i>Realizua</i>
2	17.06.05	Fak. Filozofik		<i>Planifikuar</i>	<i>Realizua</i>
3	20.06.05	Fak. Juridik		<i>Planifikuar</i>	<i>Realizua</i>
4	21.06.05	Fak. Mjekësisë	10.0 0	<i>Planifikuar</i>	<i>Realizua</i>
5	20.06.05	Fak. Filologjisë		<i>Planifikuar</i>	<i>Realizua</i>
6	20.06.05	Fak. Ekonomik		<i>Planifikuar</i>	<i>Realizua</i>
7	17.06.2005	Fak. ndërtimtarisë dhe arkitekturës	13.3 0	<i>Planifikuar</i>	<i>Realizua</i>
8	21.06.2005	Fak. Edukimit		<i>Planifikuar</i>	<i>Realizua</i>
9	21.06.05	Fak. Arteve		<i>Planifikuar</i>	<i>Realizua</i>
	21.06.2005	Fak. i inxhinierisë mekanike	11.3 0	<i>Planifikuar</i>	<i>Realizua</i>
11	21.06.2005	Fak. Kulturës Fizike		<i>Planifikuar</i>	<i>Realizua</i>
12	21.06.2005	Fak. Bujqësisë		<i>Planifikuar</i>	<i>Realizua</i>
13	21.06.2005	Fak. i inxhinierisë elektrike dhe kompjuterike	12.0 0	<i>Planifikuar</i>	<i>Realizua</i>
14	22.06.2005	Qendra e studentëve		<i>Planifikuar</i>	<i>Realizua</i>
15	21.06.2005	Fak. Shkencave matematike – natyrore		<i>Planifikuar</i>	<i>Realizua</i>

<i>Vizitate Realizuara në QKU-së & 4 Spitale Regjionale</i>						
<i>Nr.</i>	<i>Data</i>	<i>Spitalet Regjionale</i>	<i>Ora</i>	<i>E Planifikuar</i>	<i>E Realizuar</i>	<i>E Deshtuar</i>
1	7.07.2005	Qendrën Klinike Universitare		Planifikuar	Realizuar	
2	6.07.2005	Spitalin Regjional ne Pejë	11.30	Planifikuar	Realizuar	
3	7.07.2005	Spitalin e Regjional ne Gjilan	13.00	Planifikuar	Realizuar	
4	11.07.2005	Spitalin Regjional ne Mitrovicë	10.00	Planifikuar	Realizuar	
5	14.07.2005	Spitalin Regjional ne Prizren		Planifikuar	Realizuar	
6	18.07.05	Klinika Gjinekologjike	12.30	Planifikuar	Realizuar	
7	18.07.05	Instituti i Transfuzionit të Gjakut	11.00	Planifikuar	Realizuar	
8	18.07.05	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike	14.00	Planifikuar	Realizuar	

1	K.K. Ferizaj		
2	K.K. Prishtinë	Me vërejtje	Nuk e kane te emëruar menagjerin e personelit
3	Kryeministri	Janë përmbushur te gjitha rekomandimet	
4	K.K. Drenasë (Gllgovc)	Me vërejtje	Nuk e kane te emëruar menagjerin e personelit
5	M. Transportit dhe Post Telekomunikacionit	Janë përmbushur te gjitha rekomandimet	
6	K.K. Mitrovicë	Me vërejtje	Nuk e kane te emëruar menagjerin e personelit
7	M. për Administratën e Qeverisjes Lokale	Me vërejtje	Nuk është bere vlerësimi i punëtoreve ne periudhën provuese.
8	Qendra e Studenteve	Janë përmbushur te gjitha rekomandimet	
9	K.K. Gjilan	Me vërejtje	Nuk e kane te emëruar menagjerin e personelit
10	M. Tregtisë dhe Industrisë	Janë përmbushur te gjitha rekomandimet	
11	K.K. Istog		
12	Agj. Kosovës per Produkte Medicinale	Janë përmbushur te gjitha rekomandimet	
13	K.K. Obiliq		
14	K.K. Prizren	Me vërejtje	Nuk janë permb.rek. dhe Men. I Pers. Nuk ka bashkëpunuar me këshillin.
15	K.K. Malishevë	Me vërejtje	Konkurset nuk janë te shpallura ne baze te dispozitave ligjore

16	K.K. Skenderaj	Me vërejtje	Konkurset nuk janë të shpallura ne baze të dispozitave ligjore Procedurat e shfrytëzimit të pushimit të lehonisë nuk janë të bazuara ne LShC.
17	M.SH.P		
18	Kuvendi I Kosovës	Me vërejtje	Menagjerit të Personelit nuk i janë bart kompetencat
19	K.K. Vushtrri	Me vërejtje	Punëtorët e Arsimit të Komunitetit Serb nuk i kanë të nënshkruara kontratat
20	K.K. Besianë (Podujevë)	Me vërejtje	Menagjerit të Personelit nuk i janë bart kompetencat dhe konkurset nuk janë të shpallura ne baze të dispozitave ligjore
21	K.K. Therandë (Suharekë)	Me vërejtje	Konkurset nuk janë të shpallura dhe kontratat nuk janë të hartuara ne baze të dispozitave ligjore
22	M. Kthimit	Me vërejtje	Nuk e kanë zbatuar procedurën për periudhën provuese dhe nuk është bërë vlerësimi i as një punëtori. Duhet të kenë të spastruar sistematizimin e vendeve të punës cili duhet të jetë i mbuluar me buxhetin e ministrisë dhe Pranimit dhe largimi punëtorëve si tepricë të behet ne baze të procedurave të SHC. Me rastin e themelimit të kësaj ministrie nuk janë zbatuar rregullat e procedurës të ShC të parapara me nenin 7.8 dhe 9te urdhëresës adm 2003/02
23	K.K. Klinë	Me vërejtje	Menagjerit të Personelit nuk i janë bart kompetencat dhe konkurset nuk janë të shpallura ne baze të dispozitave ligjore
24	K.K. Kaçanik	Me vërejtje	Konkurset ne gjuhen serbe nuk shpallen ne mediat serbe por vetëm ne gazeta shqipe
25	IKAP	Me vërejtje	Nuk e kanë të emëruar menagjerin e personelit Nuk e kanë të formuar komisionin disiplinore e as atlete ankesave dhe Konkurset nuk shpallen ne baze të dispozitave ligjore.

26	M. Kulturës Rinisë dhe Sportit		
27	K.K. Gjakovë	Me vërejtje	Nuk është respektuar neni 12 i 2001/36 konform emërimit të drejtoreshave dhe nuk janë bart kompetencat të Menaxherit të Personelit
28	K.K. Rahovec	Me vërejtje	Nuk e kanë të emëruar menaxherin e personelit
29	K.K. Dragash	Me vërejtje	Nuk janë përmbushur rekomandimet në sektorin e Arsimit dhe të shëndetësisë
30	K.K. Lypian	Me vërejtje	Nuk e kanë të emëruar menaxherin e personelit, nuk është respektuar neni 12 i rregullorës 2001/36 mbi procedurat për emërimin e drejtoreshave dhe neni 4 pika e e rregullorës 2003/02
31	K.K. Fushë Kosovë	Janë përmbushur të gjitha rek.	
32	Ministria e Shëndetësisë		
33	K.K. Shtime	Janë përmbushur të gjitha rekomandimet	
34	M. Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor	Me vërejtje	Kontratat i nënshkruan Sekretari Permanent
35	Universiteti i Prishtinës me Fakultetet	Me vërejtje	Statuti i Unive, dhe kohëzgjatja e kontratave të harmonizohet me LShC-ne
36	K.K. Dardanë (Kamenicë)	Me vërejtje	Arsimi dhe shëndetësia nuk janë të mbuluara nga menaxheri i personelit (vetëm punëtorët serb) dhe M.P nuk i janë bartur përgjegjësit
37	M. Arsimit		
38	K.K. Viti	Janë përmbushur të gjitha rekomandimet	KONSTATOHET: gjendja është shumë e mirë
39	M. Punësë & Mirqenjë Sociale	Me vërejtje	Kontratat i nënshkruan Drejtori i administratës Qendrore e jo Men. i Personelit dhe Palët nuk njoftohen për të drejtën në Ank.u

40	Agj. Katastral i Kosovës	Janë përbushur te gjitha rekomandimet	
41	K.K. Deçan	Me vërejtje	Nuk e kane te emëruar menagjerin e personelit
42	M. Ekonomisë dhe Financave	Me vërejtje	Nuk kane menagjer te personelit Dosjet nuk janë te vendosura siq parashihet me ligj
43	Administrata Tatimore e Kosovës	Me vërejtje	Kontratat i nënshkruan Drejtori e jo Men. I Personelit
44	K.K. Pejë		Kontratat i nënshkruan Kryeshefi Egzekutiv
45	Zyra e Kryetarit te Kosovës		
46	Agj.i Inspektoratit	-----	-----
47	K.K. Leposaviq	Janë përbushur te gjitha rekomandimet	
48	Enti I Statistikës së Kosovës	Me vërejtje	Nuk e kane te emëruar menagjerin e personelit
49	M. Bujqësisë Pylltaris & Zh.R.	Janë përbushur te gjitha rekomandimet .	
50	K.K. Novo-Berd	Me vërejtje	Arsimi dhe shëndetësia nuk janë te mbuluara nga menagjeri i personelit(vetëm punëtoret serb)
51	K.K. Zveqan	Janë përbushur te gjitha rekomandimet	
52	K.K. Shtërpçë	Me vërejtje	Nuk e kane te emëruar menagjerin e personelit
53	Agj.Veterinar		
54	Agj.Pylltarisë		

Veçoritë e theksuara në funksionin e vlerësimit të rrespektimit të ligjit

Sikur edhe mund të shihet nga tabela e përmbushjes së rekomandimeve shumica e autoriteteve punëdhënëse i kanë rrespektua rekomandimet e dhëna edhe në mënyrë efektive kanë menjanuar të metat e konstatuara por vlenë të theksohet se me rastin e vizitave të para shumica e A.P. nuk kishin të emruar menaxherin personeli gjë që në mënyrë të drejtpërsëdrejtë ndikon në zbatimin e parimeve të LSHC me vonë pas rekomandimeve të dhëna shumica e A.P. i kanë të emruar M.P. dhe kjo ka ndikuar në mënyrë shumë kualitative në aplikimin e drejtë të dispozitave të LSHCK..

- Është karakteristike që disa A.P. kanë emëruar M.P. por që nga ana e zyrtarit kryesor ekzekutiv nuk i janë bartur përgjegjësitë që atij i takojnë me ligj e sidomos nuk i lejohet nënshkrimi i kontratave të punës për të punësuarit.
- Është vërtetuar gjithashtu se në disa A.P. ka pasur ngecje çështjet e vlerësimit të të punësuarëve në baza vjetore ashtu sikur parashihet me nenin 3.1(d) por që pas sygjërimeve nga ana e KPMK-së kjo gjendje është përmirësuar dukshëm.

Në këtë drejtim KPMK gjat ushtrimit të këtij funksioni ka hasur në A.P. që dallohen në përpikëshmërinë tyre në aplikimin e ligjshmërisë sikur janë: Komuna e Vitisë, Komuna e F. Kosovës, Kryeministria, Administrata e Kuvendit të Kosovës etj.

Ndërsa ka raste edhe ku shkalla e aplikimit të ligjshmërisë është me e vogël si psh në MKK (Ministria e Kthimit dhe Komuniteteve) sidomos në fazën e parë të pranimit të punëtorëve pa kritere të qarta dhe pa rrespektim

konkursi .Në periudhat e mëvonshme kohore kjo është evituar. Në muajin gusht 2005 në këtë Ministri si pasojë e shkurtimeve buxhetore ka pasur ndërprerje të kontratave tëpunës për 61 punëtorë dhe disa nga ta kanë ushtruar ankesa në KPMK të cilat janë në procedurë për tu zgjedhur.

Edhe në Komunën e Prizerenit janë shfaqur mangësi kooperimi me KPMK-në.

Funkcioni i vëzhgimit të emrimit të drejtorëve të departamenteve

Më rregullorën 2001/36 mbi SHCK ,saktësisht me nenin 12 të sajë është përcaktuar e drejta e vëzhgimit të emërimit të Shërbyesëve civil në nivel të drejtorëve të departamenteve .

Është hera e parë që një procedurë të tillë të emërimit të drejtorëve më legjislacion të parashihet vëzhgimi nga një komision i KPMK-së i cili do të ishte garantues i transparencës dhe aplikimit të procedurave të parapara me ligj dhe akte tjera juridike.

Këshilli i Pavarur Mbikqyrës në këto vizita monitoruese është prezantuar me komisione me nga tre anëtar.

Komisionet e këshillit në rastet konkrete të vëzhgimit kanë kërkuar të konstatojnë rrespektimin e parimeve udhëheqëse të SHCK


- nëse komisioni intervistues është formuar në mënyre të rregullt dhe nëse përmbushë kriteret e parapara me nenin 7.2 të UA
- shpalljen e konkursit dhe përshkrimin e vendit të punës
- listën e kandidatëve konkurues me dëshmitë mbi kualifikimin
- tërë procedurën e intervistimit
- listën përfundimtare të poentimit të kandidatëve
- çdo dokument tjetër relavant për procesin e selektimit

Gjatë periudhës kohore për të cilën raportohet KPMK-ja ka kryer 56 vizita vëzhgimi nëpër A.P. ku është zhvilluar proceduara e emërimit të drejtorëve dhe këshilli ka formuar komisionet përkatëse..

Lidhur me këtë shif tabelën e mëposhtme me radhitjen e A.P.të vizituara dhe emërtimin e postit të drejt,të dep që duhej të zgjedhej të shoqëruara me grafikonet përkatëse që pasqyrojnë aktivitetin e KPMK-së në këtë drejtim.

autoriteti punedhenes	Data e vizites	Dt e nx.se vendimit	Dep .- Drejtorati
Minis.e energjeti.Minje.	-----	16.03.2005	Dep. Minjerave
Minis e BPZHRI		16.03.2005	Dep.Prokurimit
Ministria e MPH		16.03.2005	Dep.Prokurimit
Minis e BPZHRI		19.04.2005	Dep I prodh. Dhe mb.bim.
Minis e BPZHRI		26.04.2005	Dep.Prokurimit
Kom. E Dragashit		29.04.2005	drej. Per shendetesi
MEM		17.05.2005	Dep per Energjetike
MEM		17.05.2005	Dep per Str. Dhe Zhvill.
MEM		25.05.2005	Dep per Miniera
Kom. E Dragashit		31.05.2005	Drej. Per buxhet , financa
Kom. E Dragashit		31.05.2005	Drej per bujqesi, zh.Rural
Kom. E Dragashit		31.05.2005	Drej, per Urb.Plan.Investi.
Ministria e TPT		03.06.2005	Drejt. E rrugeve
Ministria e TPT		03.06.2005	Dep.Prokurimit
Kom. E Dragashit	23.06.2005	22.06.2005	Drej per Ars,demok,medja
MEM	26.07.2005	21.07.2005	Dep.Prokurimit
Ministria e I.Tregtis	27.07.2005	25.07.2005	Dep.Metrologjis
Komuna E Mitr.	28.07.2005	21.07.2005	Drej per Urb.Plan.Rin.Ban
Komina e Lepasaviqit	08.9.2005	06.09.2005	Zyra per komunitete
Minis e Shendetsis		20.09.2005	Dep.per zhvill.strategjik
Ministria e I.Tregtis		05.10.2005	Dep.Metrologjis
Komuna E Mitr.	13.10.2005	11.10.2005	Drej per Buj dhe Mb Amb.
QKU	26.09.2005	09.09.2005	Klin. E Pediatrise
QKU	26.09.2005	09.09.2005	Klin. Obstetrike-Gjinekolo
QKU	26.09.2005	09.09.2005	Klin. E ORL-se


QKU	27.09.2005	09.09.2005	Klin. E Anesteziologjis
QKU	27.09.2005	09.09.2005	Qendra Diagnostike
QKU	27.09.2005	09.09.2005	Institutet
QKU	28.09.2005	09.09.2005	Klinika interne
QKU	28.09.2005	09.09.2005	Qendra emergjente
QKU	29.09.2005	09.09.2005	Klinika e dermartovenerol.
QKU	29.09.2005	09.09.2005	Klin e neorologjis
QKU	29.09.2005	09.09.2005	Klin e oftamologjis
QKU	29.09.2005	09.09.2005	Klin infektive
QKU	03.10.2005	09.09.2005	Klin e mushkrive
QKU	03.10.2005	09.09.2005	Qendra nacionale ortoped.
Ministria e TPT	18.10.2005	11.10.2005	Dep I Automjeteve
Komuna E Mitr.	13.10.2005	11.10.2005	Drtej.per buj. Dhe mb te A
Minis e BPZHRural	20.10.2005	14.10.2005	Deper I Adminis Qendrore
Ministria e TPT	08.11.2005	01.11.2005	Deper I rrugeve
Ministria e TPT	09.11.2005	08.11.2005	Dep.Prokurimit
MShP	15.11.2005	15.11.2005	Deper I Adminis Qendrore
Minis e BPZHR		23.12.2005	Zyra ligjore ne mardh publik
Ministr e KRS		23.12.2005	Dep I Kultures
Ministr e KRS		23.12.2005	Dep I Rinis
Ministr e KRS		23.12.2005	Dep I Sportit
Ministr e KRS		23.12.2005	Dep I QJR-ve
Ministr e KRS		23.12.2005	Dep I Adm. Qendrore
MEF	20.01.2006	13.01.2006	Drej Te Tek. Informative
QKU	20.01.2006	13.01.2006	Klin e Peditrise
MEF	30.12.2005		Dep I poli. Fiskale

Vizitat për vëzhgimin e procedurës së zgjedhjes së drejtorëve të departamenteve

Agjenda:

1. Drejtorët e Departamenteve të Ministrive-31
2. Drejtorët në QKU -15
3. Drejtorët e komunave -10

Gjithsejt- 56



Veçoritë e theksuara në funksionin e vëzhgimit të emrimit të drejtorëve të departamenteve

Kryesisht procedurat e zgjedhjes së drejtorëve të departamenteve janë zhvilluar në përputhje me procedurat ligjore.

Kishte raste edhe të mangësive të konstatuara siq janë:

Mos shpallja e konkursit sipas kritereve të nenit 4 të UA 2003/2

Mos vazhdimi i afatit të konkurrimit të aplikuesëve edhe për një afat tjetër prej 15 ditëve sikur parashihet me nenin 4.2,shkronja (g) të njejtës UA

Përbërja e komisioneve intervistuese në kundërshtim me dispozitën e nenit 7.2 të UA i cili parasheh balancin gjinor dhe etnik .

Mos veprimi sipas nenit 7.3 të UA(2003/2)

Të gjitha këto të meta janë konstatuar në fazën fillestare të funksionimit të Këshillit por më vonë në shumicën e Autoriteteve Punëdhënëse janë tejkaluar. Autoritetet punëdhënëse në këtë drejtim kanë kërkuar shumë shpesh sqarime nga KPMK-ja dhe sqarimet e kërkuara u janë ofruar e krejt kjo në kuptimin e zbatimit të procedurave të parapara me ligj.

Komente të përgjithëshme

Këshilli i Pavarur Mbikqyrës i Kosovës konstaton se gjat vitit 2005 është zhvilluar aktivitet efektiv dhe janë arritë rezultate pozitive. Në fazën fillestare të punës së tij në shumicën e A.P. nuk ishin të emëruar menagjerët e personelit që sipas KPMK-së janë personat kyq brenda A.P. që merren me menagjimin e procedurave ligjore dhe resurseve njerzore në A.P. e që me aktivitetin direkt të KPMK-së është arritur që në shumicën e Autoriteteve Punëdhënëse menaxherët e personelit jo vetem të emërohen por edhe të marrin kompetencat e parapara me dispozita ligjore dhe kjo ka ndikuar dukshëm në ngritjen e proceseve pozitive në SHCK në aspektin e zbatimit të ligjit në mënyre kualitative.

Në fushën e arësimit edhe pse me ligj të përcaktuar si shërbyes civil dhe marrin paga nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, Këshilli ka konstatuar se në shumicën e komunave edhe pse pikërisht Komunitat formalo-juridikisht janë punëdhënës nuk kanë qasje në dosjet personale të të punësuarëve. Në disa komuna punëtorët arsimor të minoritetit sërë marrin paga por refuzojnë të nënshkruajnë kontratat e punës.

Ndërsa është evidentuar paqartësi tek zgjedhja e ankesave të punëtorëve arsimor në arsimin parashkollor, fillor e të mesëm ku disa ankesa zgjedhen nga komisioni i ankesave të komunës e disa nga komisioni i ankesave të Ministrisë me involvimin e shpeshtë të inspektorëve regional të arsimit.

Në këtë drejtim Ligji mbi SHCK përcakton se secilia A.P. duhet të ketë një komision të ankesave kompetencë ekskluzive e të cilit është marrja e vendimeve mbi ankesat e parashtruara.

Gjithashtu në sferën e shëndetësisë dosjet personale janë të shpërndara nëpër entet shëndetësore: Në spitalet regjionale, QKU dhe në disa Klinika që , funksionojnë pothuajse si autoritete të pavarura edhe pse me rreg.2001/19 si Autoritete Punëdhënëse

janë përcaktuar Ministrinë dhe Agjencionet Egzekutive, ndërsa menaxheri i personelit të kësaj Ministrie ka qasje në dosjet e personelit vetëm të stafit administrativ të të punësuarve në ndërtesën e Ministrisë.

Këshilli mendon se në këtë drejtim është e domosdoshme ngritja e rregullativës ligjore që do të definonte kështu kompetencat dhe përgjegjësitë në këto dy sfera të shërbimit civil.

Sfidat dhe vështirësitë

Një nga vështirësitë më të theksuara me të cilën është përballur këshilli gati gjatë gjithë kohës së funksionimit të tij ishte moskompletimi me nurmin e anëtarëve sipas ligjit.

Prej kohës kur është formuar e deri më ditën kur ky raport është pregaditur KPMK vetëm një periudë të shkurtë kohore ka qenë në përbërje të plotë prej 7 anëtarësh ndërsa prej 30 marsit deri në 17 nëntor në një periudë kishte vetëm pesë anëtarë. Kjo ka pasur si pasojë probleme praktike në kryerjen efikase të detyrave të punës së këshillit sepse shumë here Këshilli është ndeshur me situata ku është dashur të angazhohet më shumë anëtarë për aktivitete konkrete se sa që në realitet ka pasur, ndërsa aktivitetet kanë qenë të limituara me afate kohore.

Në disa raste KPMK në mungesë të numrit të paraparë të anëtarëve Nuk ka qenë në gjendje të formojë komisione të cilat do përbëheshin nga tre anëtarë për secilin nga funksionet që ka e që shpesh herë ka ndodhur të jenë në agjendë dy aktivitetet të përnjëherëshme në dy funksione të ndryshme.

Rekomandimet e KPMK-së

Për të rritur shkallën e zbatimit të Ligjit mbi Shërbimin Civil, KPMK- vlerëson së është e nevojshme:

- që kjo të ligj të përcaktohet mënyra e ekzekutimit të vendimeve të tij.
- Që çështja e avancimeve brenda Shërbimit Civil të elaborohet taksativisht për të shmangur dilemat që vazhdimisht qfaqen tek A.P.
- KPMK të shtojë përpjekjet për informimin e opinionit në përmes të mjeteve të informimit publik, fletushkave dhe buletineve për rolin e KPMK-së dhe të drejtat e shërbyesëve civil lidhur me KPMK-në
- të shtohet bashkëpunimi e kooperimi me organe e organizata vendore e ndërkombëtare nga lamia e Shërbimit Civil dhe Administratës.
- Që KPMK të krijojë një strategji të kjo të veprimit
- Që të inicohet çështja e transformimit të këshillit në përputhje me nenin 7.2 të rreg. Mbi SHCK (2001/36)
- KPMK së bashku me DASHC dhe IKAP të involvohet aktivisht Në procesin e reformimit të SHCK.

Këshilli i Pavarur Mbikqyrës i Kosovës më këtë rast shprehë mirënjohje Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të KB për kujdesin që ka tregua gjatë emërimit të anëtarëve të KPMK-së,

-Kryeministrin e Kosovës për angazhimin në miratimin emërimeve dhe dhënjejn e pëlqimit për rregulloret e Këshillit

Ministren e Ministrisë së Shërbimeve Publike për angazhimin e vazhdueshëm në sigurimin e stafit mbështetës për këshillin dhe ofrimin e shërbimeve logjistike si dhe në hartimin e dy rregulloreve të domosdoshme për punën e KPMK-së.

OSCE dhe Departamentet e Shërbimeve Civile të UNMIK-ut për bashkëpunim korrekt

CMPS me seli në Londër për trajnimin e anëtarëve të Këshillit dhe Ofrimin e këshillave të vazhdueshme

Të gjitha Autoritet Punëdhënëse në Shërbimin Civil të Kosovës për qasje rrespektabile ndaj Këshillit.

Këshilli rithekson gadishmërinë e tij për bashkëpunim me të gjitha subjektet e interesuara dhe mirëpret të gjitha iniciativat në këtë drejtim.

Të vetëdijshëm se nuk kemi mundur të paraqesim të gjitha në këtë raport vjetor pune këshilli i do të shqyrtoj me kujdes të gjitha sygjerimet dhe kritikrat eventuale.

Këshilli i Pavarur Mbikqyrës i Kosovës

